

Nr. _____ Prot.

Patos më, _____.____.2021

NJOFTIMI I ANKANDIT

1. **Autoriteti Shitës:** Albpetrol Sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7.
2. **Data e zhvillimit të ankandit:** 04.03.2021, ora 11:00.
3. **Lloji i Procedurës të ankandit:** Procedure e hapur.
4. **Objekti i Shitjes:** Shitje nafte brut, sasia 120 000 ton në total, të ndarë në 2(dy) lote:
 - Loti i parë në sasinë prej 40 000 ton naftë brut, për përpunim në tregun vendas.
 - Loti i dytë në sasinë prej 80 000 ton naftë brut, për eksport.
5. **Afati i evadimit:**
 - Loti i parë (sasia 40 000 ton) afati i evadimit do të jetë 8 (tetë) muaj nga data e fillimit të evadimit.
 - Loti i dytë (sasia 80 000 ton) afati i evadimit do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e fillimit të evadimit.
6. **Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje e naftës brut, 120 000 ton në total, e ndarë në 2(dy) lote:
 - Loti i parë në sasinë prej 40 000 ton naftë brut, për përpunim në tregun vendas.
 - Loti i dytë në sasinë prej 80 000 ton naftë brut, për eksport.
7. **Vlera fillestare:**
 - a) **Në kushtet FOB është:**
Çmimi minimal fillestar për njësi është:
72.89 % e Çmimit Brent + K
 - b) **Në pikat e lëvrimit për lotin e parë (sasia 40 000 ton):**
Çmimi minimal fillestar për njësi është:
72.89 % e Çmimit Brent – 3.31 USD/bbl + K
 - 72.89 % është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare të naftës (pesha specifike, aciditeti i naftes, % e squfurit).

- Brent është çmimi në USD/bbl i Brent i Platts, i publikuar në Buletinin e Prokurimit Publik.
- 3.31 USD/bbl kosto mesatare totale (transport, magazinim, stokim, analizim produkti, sigurim).
- K- është vlera USD/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal të shitjes të përlogaritur nga formula ($K \geq 0$).

c) Në pikat e lëvrimit për lotin e dytë (sasia 80 000 ton):

Çmimi minimal fillestar për njësi është:

72.89 % e Çmimit Brent – 3.55 USD/bbl + K

- 72.89 % është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare të naftës (pesha specifike, aciditeti i naftes, % e squfurit).
- Brent është çmimi në USD/bbl i Brent i Platts, i publikuar në Buletinin e Prokurimit Publik.
- 3.55 USD/bbl kosto mesatare totale (transport, magazinim, stokim, analizim produkti, sigurim).
- K- është vlera USD/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal të shitjes të përlogaritur nga formula ($K \geq 0$).

8. **Vendndodhja e naftës brut: Albpetrol sha Patos:** Për të dy lotet vendndodhja do të jetë, në pikat e lëvrimit Stacioni Usoje, Stacioni Visoke, Stacioni Gorisht, Stacioni Zharrëz, Stacioni Kuçovë, Stacioni Amonice.

9. **Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati I, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.

10. **Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** në zyrën e protokollit Kati 1 tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 04.03.2021, ora 11:00.

11. **Data e hapjes së ofertave:** datë 04.03.2021, ora 11:00, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati I, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.

12. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentat e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës me paraqitjen e një kërkesë me shkrim ose në faqen zyrtare të “Albpetrol” sha www.albpetrol.al dhe në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë www.infrastruktura.gov.al.

Dokumente me pagesë:

Po



Jo

X

13. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, përpara datës dhe orës së zhvillimit të ankandit, në vendin e përcaktuar në dokumentat e ankandit.